

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS - OPŠTINA MITROVICA

02 01.052/01-0003687/26

Nr i Sq./D. nr _____

Ngjarje/Dirigim _____ 21.01.2026

Sehri/ia _____ Mitrovicë - Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južne Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Drejtoria Për Mirëqenie Sociale

Raporti i Punës
Janar – Dhjetor 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DREJTORIA PËR MIRËQENIE SOCIALE

Raporti i punës për Periudhën Janar – Dhjetor 2025

- 1) **Spektori për Mirëqenie Sociale dhe Strehim**
- 2) **Spektori për Kategoritë të Dalura nga Lufta**

Spektori për Mirëqenie Sociale dhe Strehim, aktivitetet e punës i mbështet në dispozitat ligjore të Republikës së Kosovës të cilat e rregullojnë lëminë e Mirëqenies Sociale dhe të strehimit.

Drejtorja për Mirëqenie Sociale duke u mbështetur në të dhënat në dispozicion dhe gjendjen reale në terren, konsiderojnë se numri i kërkesave të shumta për ndihma ushqimore – higjienike, strehim, pagesën e qirave të banimit, është i arsyeshëm.

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2025, kemi pranuar 683 kërkesa të ndryshme prej të cilave 579 janë aprovuar – pozitive, 104 janë refuzuar – negative dhe .

Për pako ushqimore janë dhënë 639 kërkesa prej tyre 579 janë pozitive , 104 janë negativë

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2025, (përveç kërkesave nga vitet paraprake), nuk ka pasur kërkesa të paraqitura për banim social nga familjet që plotësojnë kushtet e as kërkesa për strehim momental.

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2025, janë realizuar projekte dhe veprime punuese si në vijim:

Ne periudhën kohore Janar – Dhjetor 2025, kemi qenë të angazhuar në vizitat që kryen Komisioni tek familjet të cilat aplikojnë për pagesë të qirasë, dhe identifikimin e rasteve, të cilat jetojnë në kushte të vështira jetese.

Mbështetja financiare për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2025 në pagesën e qirasë për 20 familje me **shumë totale 14888.68 €**. Pas aplikimit të kërkesës së këtyre familjeve në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, është bërë verifikimi i dokumentacionit si dhe janë realizuar vizitat familjeve në fjalë.

Më 04.12.2024, është nënshkruar Marrëveshja një vjeqare me për Kryerjen e Shërbimeve dhe Ceremonive Fetare në mes të BIK-ut dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut për pagesën e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Mitrovicës së Jugut, me numër të Protokolit 01-352/05-0077524/24 e datës 04.12.2024 dhe mbaron me datë 14.10.2025 dhe me mundësi vazhdimi.

Janë kompletuar raportet dhe Faturat për Pagesat e shërbimeve të varrimit- borxhet për muajin Dhjetor 2024, dhe janë ekzekutuar në **shumën prej 19,020 € (nëntumdhjetmijë e njëzet euro)**; Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2025, janë ekzekutuar mjetete financiare për muajit Janar deri në gjysmën e muajit Tetor, (deri me 14 . 10. 2025 deri sa ka pasur marrëveshje me BIK-un në Mitrovicë) në **shumën prej 140.645 € (njëqind e kartërdhjet mijë e gjashqind e katërdhjetë e pesë Euro)**;

Shuma totale për pagesat e shpenzimeve të varrimit për muajin dhejtor 2024, dhe nga fillimi i muajit Janar 2025 deri me 14.10.2025, është **159.665 € (njëqind e pesëdhjet e nënt mijë e gjashqind e gjadhjetë e pesë Euro)**; kjo marrëveshje në mes të Komunës së Mitrovicës dhe Bashkësin Islame në Mitrovicën e Jugut përfshinë edhe komunat veriore siq janë: Komuna e Leposaviqit, Komuna e Zveçanit dhe Komuna e Zubin Potokut.

Nënshkrimi i Memorandum mirëkuptimi në mes të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale në Istog dhe DMS-së, Mitrovicë e Jugut për bashkëpunim ndër Komunal për shkëmbimin e përvojave dhe aktiviteteve të përbashkëta për përkrahjen e moshës së tretë, nr. protokoli 16-030/01-0025095/24 data 11.04.2024.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në shkurt të vitit 2024, me QKRMT-në (Qendra e Kosovës për Rehabilitimin e të Mbijeturave të Torturës), nr.protokoli 16-030/01-0025125/24 data 19.04.2024. Ky projekt dy vjeqar ofron shërbime të psikologut dhe përfaqësuesit Ligjor pa pagesë për të mbijeturat e torturës, rehabilitimi dhe re-integrimi i të miturave – viktimat të dhunës seksuale

në Kosovë. Kjo do bëhet përmes mbështetjes psikologjike dhe zyrtarëve ligjorë, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve shtetërore të mbështetur nga Ambasada Britaneze.

Komisionit për verifikimin e Banesave të banimit Social i caktuar nga Asamblea Komunale numër 02-060/01-060/01-0006466-8/23 i datës 03.02.2023 me afat kohor dy vjeçar, ka kryer vizitat e familjeve të strehuara ne banesat Sociale dhe ne kompleksin banesor ne Frashër për mundësinë e evidentimit të rasteve të dyshimta dhe të keq përdorimit të tyre

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2025, janë lëshuar 25 vërtetime për familjet e dëshmorëve Invalidë, Ushtarak dhe Civil si dhe për Viktima Civile të luftës.

Ndërtimi i objektit te Strehimorës është përfunduar. Ne jemi në pritje të përgjigjes nga UNMIK-U, për vazhdimin e përfundimit të rrethojës së objektit dhe sigurimin e inventarit me kuzhinë, ne menyrë qe sa me parë të pranojmë zyrtarisht nga UNMIK-u Objektin e përfunduar. i njëjti duhet te kalojë ne procedurat e regjistrimit si pronë Komunale ne Drejtorinë e Katastrit dhe Urbanizmit, dhe me pas të vihet ne funksion.

Ne periudhën kohore Janar – Dhjetor 2025, zyrtarët e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale kanë qenë të angazhuar në vizita ne Fshatin Frashër tek objekti Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijëve, ku ende ka mbetur pa përfunduar projekti nga UNMIK-ut, ku ende nuk e kanë kryer rrethojen e objektit sipas marveshjes, edhe pas disa takimeve zyrtare qe ka pasur Drejtoresha e Drejtorisë doc.znj.Drita IBRAHIMI me zyrtarë të UNMIK-ut, ku ka kërkuar disa herë me shkrim përgjigje për ngecjen e rrethojës, dhe ende nuk ka marr përgjigje.

Me 02.06.2025 zyrtarët e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe zyrtarë nga OSB – ja e kanë vizituar Objektin ne Fshatin Frashër Qendren për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijëve.

Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me Ambasadën e UAE, Podgoricë, me 25.03.2025, për pako ushqimore.

Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me OJQ-në Amaneti me Seli në Prishtinë me nr.01 – 550/01 – 0017687/25 me 25.03.2025 për pako ushqimore.

Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me OJQ-në HUMANITY FIRST me nr. 16-553/01 – 0029943/25 të dates 22.05.2025 për pako ushqimore(mish kurbaní) për 100 familje.

Ka vazhduar Furnizimi në kontinuitet me pako ushqimore për famljet në vështërësi. Kjo bëhet sipas kërkesave të qytetarëve të cilat i paraqesin pranë Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, duke i vizituar dhe vlerësuar paraprakisht. Gjithashtu edhe përmes detektimit të rasteve nga ana e zyretarëve në terren.

Drejtoria për Mirëqenies Sociale gjatë muajit Janar – Dhjetor 2025 ka pranuar këto donacione:

250 Pako ushqimore nga OJQ Ilsamic Relieff Kosova.

300 Pako ushqimore nga Ambasada e UAE nga Podgorica.

200 Pako ushqimore nga OJQ-ja Amaneti me Seli në Prishtinë.

100 Pako ushqimore (mish) nga OJQ-ja Humanity First.

221 Pako ushqimore (mish) nga OJQ Ilsamic Relieff Kosova.

78 Pako ushqimore (mish) nga OJQ International Charity Organization

Nga këto donacione janë ndihmuar rastet sociale dhe familjet në gjendje të vështire financiare si dhe Komunitetet, familjet me persona me aftësi të kufizuara, familjet në vështirësi të Shoqatave të dala nga lufta dhe pensionistët-rastet në vështirësi të moshës 65+.

Ne bazë të planit të përbashkët me QPS-në, janë realizuar ligjerata në Shkolla të ulta dhe Shkolla të mesme të lartë gjithsejt 15 sesione sensibilizuese për ngritjen e vetëdijesimit të tyre, si dhe informimi për pasojat e mundëshme nga martesat e herëshme, mbrojtja nga dhuna në baza gjinore, dhe me theks të veçantë mbrojtja e fëmijëve nga dhuna.

Një nga problemet shqetësuese ne Drejtorin për Mirëqenie Sociale është mungesa e stafit të punës qe nga vitit 2020 dhe 2021 e këndej, ku kanë shkuar dy zyrtarë ne pension, kurse gjatë vitit 2023

dhe 2024 dy zyrtarë kanë kaluar ne Drejtori tjera, dhe vendet e tyre kanë mbetur pa u plotësuar ende, edhe përkundër faktit se Drejtoresha e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale. Doc. znj. Drita Ibrahimimi ka kërkuar me kërkesë disa herë shpalljen e konkursit përmes Menaxherit të Burimeve Njerëzore për kompletimin e stafit të Drejtorisë, por çdo herë ka pasur refuzim, dhe stafi ende është i pa kompletuar.

Drejtoreshë e Drejtorisë për
Mirëqenie Sociale
Dr. Drita IBRAHIMI

